

Luciano BOCI
IDENTITETI EVROPIAN I ROMANIT SHQIPTAR

Në vitin 2014, kanali i njohur francez Arte, transmetoi një seri dokumentarësh, nën okelion “Evropa e shkrimtarëve”. Synimi i dokumentarit ishte rrëfimi i historisë së vendeve evropiane përmes letërsisë, duke marrë në shqyrtim romancierët më të spikatur të periudhave të ndryshme.

Parimi i ndjekur ishte ky:

“Historiani dhe romancieri mund të këmbejnë vendet, ndërkohë që mbetet, ama, një ndryshim. Nga romancieri presim përzjerjen e të vërtetës me falsen, të dyja të përthithura në konceptimin trillimin e veprës letrare; nga historiani kërkojmë, në vend të saj, të vërtetën. Që nuk trillon. Që nuk trillon qëllimisht”i.

Ajo që spikaste më shumë ishte se në historitë letrare të rrëfyera të parashtruara në veprat romaneske të shkrimtarëve, Italinë e gjeje e prekje dhe tek shkrimtarët gjermanë, Gjermaninë dhe tek ata francezë, Francën dhe tek shkrimtarët anglezë e të gjithë së bashku nga pak tek njëri-tjetri.

Dokumentari zbulonte një gërshetim e përbashkësi historish, kulturash, mendësish, konceptesh perceptimesh si ç’është jeta, dashuria, vdekja, përbashkësi vlerash, tabush, qëllimesh që zbuloheshin nëpërmjet ligjëritimit letrar, procedimeve të zhdërvjellëta, kontesteve të manipuluar me figuracion të kuptueshëm për çdo lexues pavarësisht vendit nga ishte romancieri, apo është lexuesi.

E thënë ndryshe shumë thjeshtë, dokumentari zbulonte krahas identitetit kombëtar, identitetin evropian të vendeve evropiane përmes identitetit letrar, brenda të cilit romani duket qartë të ketë një rol specifik. Dokumentari dukej sikur konfirmonte dhe njëherë tezën se ndryshimet thelbësore të dekadave si historikisht, ashtu edhe politikisht, por dhe nga pikëpamja shoqërore dhe kulturore, nuk mund të interpretohen e të kuptohen pa ndihmën e artistëve, regjisorëve dhe sidomos shkrimtarëve.

E në të gjithë këtë panoramë të shtjelluar, pyetja më e natyrshme ishte: Po Shqipëria, po letërsia e saj dhe sidomos po romani i saj.

Këtu nuk pretendoj të hap një polemikë mbi identitetin, sepse çështja e identitetit evropian të shqiptarëve e ka kapërcyer kohën e polemikave dhe gjithëpranimi i përkatësisë së letërsisë shqiptare në rrethin kulturor evropian, është një çështje pa ekuivok.

Pavarësisht këtyre definicioneve ndonjëherë me natyrë aksiomatike, duket se debati mbetet dhe parashtrimi i argumenteve është një kontribut i kërkuar. Në këtë linjë është ndërtuar dhe struktura e këtij punimi.

Letërsia ka qenë dhe mbetet një ndër faktorët kryesorë identitet-formuese në Evropë, për arsye se ajo më së miri sintetizoi brenda saj, që nga Iluminizmi e deri në ngjarjet e shekullit XX, prirjet kulturore, shpirtërore, historike e antropologjike të një kontinenti i cili më shumë se kushdo tjetër instaloj një identitet i cili ka ndikuar dhe vazhdon të ndikojë me rrezatimin dhe forcën e tij, kudo ku ai shfaqet.

Për vendin tonë, specifika historike dhe politike, bëri që ajo të shërbejë akoma më shumë si katalizatori kryesor i identitetit kombëtar. Letërsia ishte dhe mbeti aktiviteti themelor i ndërtimit të imazhit të vetvetes në raport me imazhin e tjetrit si një ballafaqim dhe bashkërendim me identitetin evropian. Prodhimi letrar i saj dokumenton qartë momentet historike brenda të cilave kombi është përballur dhe vazhdon të përballët, duke konkurruar e duke vënë shpesh në dyshim historinë si rrëfimi perfekt.

Por jo çdo gjë ka qenë kaq e thjeshtë në këtë bashkërendim. Duhet thënë se harta gjeografike dhe harta kulturore e Evropës nuk përkojnë tërësisht. Dhe për shkak të përkatësisë gjeografike dhe fatit shumë herë të mbrapshtë historik, Shqipëria është përballur shpesh me çështje të orientimit kulturor dhe politik: zgjedhjen midis "Lindjes" dhe "Perëndimit".

Në shumicën e rasteve, zgjedhja e saj ka qenë perëndimi, por përplasja kulturore ka lënë gjurmët e saj dhe qasjet historiko-politike dhe kulturore të rajonit ballkanik tregojnë se shqiptarët, sikurse popujt tjerë, e shohin të domosdoshëm të dëshmojnë përkatësinë e tyre identitare ndaj Evropës dhe kulturës perëndimore.

Rruga më deklarative, më afirmuese dhe më shumë efikase ka qenë padyshim letërsia. Ndonëse e shfaqur vonë në horizontin kulturor evropian, letërsia shqiptare në themel të së cilës qëndron një nga gjuhët më të vjetra të familjes indoevropiane, nuk cedi nga shtrati i saj origjinar. Ajo në tërësinë e saj mbetet një letërsi thelbësisht evropiane në frymë, vokacion, strukturë, estetikë, tendenca zhvilluese diakronike e sinkronike.

Jo të gjitha rrymat e mëdha letrare të shekullit XIX kanë ekuivalentët e tyre në letërsinë tonë. Ndoshta aty është e kotë të kërkojmë brenda saj të përvijuar Barokun, Klasicizmin apo simbolizmin, megjithëse ndikimi i metodave dhe i rrymave letrare franceze e evropiane është i dukshëm. Por kjo nuk i pengoi autorët më të spikatur të humanizmit, Romantizmit, Realizmit, Modernizmit shqiptar, të shpalosnin me profilet e tyre të spikatura kombëtare, identitetin evropian si Tjetri në raport me identitetin kombëtar si Vetja.

Ky identitet i vëzhguar thellësisht është njëkohësisht dhe burimor që në gjenezë.

Baza e nisjes së çdo letërsie kombëtare evropiane që është dhe gurthemeli i identitetit, pa dyshim mbeten eposet, si lëndë parësore mitologjike letrare. Iliada e Odisea, Këngët e

Nibelungëve, të Sidit apo të Rolandit, përpos të qeni epose kombëtare janë njëherazi evropiane. Dhe brenda këtij konstelacioni bën pjesë dhe Eposi shqiptar i Kreshnikëve. Natyrshëm letërsia shqiptare ndoqi forcën e gjenit dhe dilemat e saj të shtuara për shkak të shfaqjes së vonë, por dhe për shkak të ngushticës gjuhësore të imponuar nga pushtimi i gjatë, u zgjidhën shpejt.

Autorët e saj romantikë, nën ndikimin e letërsive evropiane, por dhe frymës novatore të letërsive të rrethit kulturor joevropian, si dhe nën influencën arbëreshe, e shndërruan letërsinë në një zëdhënese të çështjes kombëtare. Njëjtë sikurse e kishin shndërruar letërsinë shkrimtarët evropianë, shekuj më parë, si zëdhënese të thirrjes për të mbrojtur atdheun kundër pushtimit dhe kërcënimit të osmanëve.

Tiparet e saj evropiane u konsoliduan njëherazi falë dhe rolit të saj si mbjellëse dhe ruajtëse e gjuhës kombëtare, e cila arriti t'i mbijetojë përpjekjeve asimilues e përjashtuese të kohërave të pushtimit. Më pas, Realizmi i post pavarësisë, ishte për letërsinë tonë një marshim identitar evropian në shtratin kombëtar, për t'u lëkundur kohë më vonë në vitet e diktaturës së Realizmit socialist, shpëtimtarët e të cilit u bënë talentet e fuqishëm dhe disidentët dhe për t'u afirmuar i plotë në letërsinë e pas viteve 90, kohë kur letërsia shqipe kapërceu përfundimisht si njohje dhe kufijtë identitarë konvencionalë shqiptarë.

Pas kësaj, ajo shtjellohet si alternim i identitetit kombëtar me të atë evropian dhe ndjek natyrshëm përshtatjen e vetes identitare në raport me Tjetrin, si identitet i përbashkët evropian. Gjithçka ndodh brenda një alternimi dhe nuk është mbivendosje. Mbivendosja me lojën e peshave të saj do të zbalancojë të dy identitetet që në fakt më shumë fuzionohen natyrshëm duke ruajtur me kujdes ngjyrat e gjithsecilit.

Brenda kësaj letërsie, romani ka një vend dhe rol të veçantë në formësimin e transmetimin e identitetit kombëtar, falë estetikës, narratives dhe tipologjisë së tij. Romani Shqiptar daton vonë dhe ngjitja e tij është e ngadaltë, por e sigurt drejt përqafimit të identitetit evropian. Pas kësaj rrugëtimi i tij ndjek hullinë e romanit evropian në formë, stil, mbarështrim, problematikë, imazh, formë rrëfimi, imazh e strukturë.

Si roman i parë nga shumica e studiuesve konsiderohet ai i Dom Ndoc Nikajt, apo siç e përcakton studiuesi Robert Elsie, i babait të romanit shqiptari, "Shkodra e rrethuar" i botuar në 1913 së bashku me "Ulqini i marrun" i po këtij autori. Romani është i shkurtër dhe ka në qendër rrethimin e Shkodrës përgjatë luftës ballkanike të 1912. Romani ka një strukturë të thjeshtë në formën e një kronike historike të letrarizuar.

Rrëfimi është i thjeshtë dhe aksioni ndjek një linjë të pastër kronologjike me pak kthime pas. Në shërbim të tezës sonë pavarësisht nivelit artistik romani është tërësisht një roman me nota identitare, jo vetëm për shkak të temës patriotike, por dhe të thjeshtësisë së kumtimit të ngjarjes dhe mesazhit që kërkon të mbartë dhe të përcjellë. Romani ka pak a shumë strukturën e frymën e kronikave mesjetare evropiane, brenda të cilave aktet heroike prevalojnë mbi ngjarjen.

Ndonëse është ende në fillimet e tij, ai shfaq tendencën e romanit historik evropian për të cilin C. Bernard përcaktonte : “Me të njëjtën të drejtë si Historia, ky zhanër shfaq kërkesën për të (ri)krijuar të shkuarën, ndijimet, mentalitetet e saj, duke i përfshirë ato estetikishtii

Megjithatë pamja evropiane e romanit historik shqiptar ende nuk është e qartë. Për më tepër diskutimi merr hov nga fakti se para Nikajt, kemi botimin e romanit të Sami Frashërit “Dashuria e Talatit me Fitneten”, më 1872, “që përgjithësisht merret si romani i parë turqisht e, njëherazi, romani i parë i shkruar dhe i botuar nga një shqiptar”iv. Me histori sentimentale dashurie me personazhe shqiptare, me një problematike shoqërore osmane e përfundim pothuaj e tipit Romeo dhe Zhuljeta, ky roman dëshmon dilemën identitare të fillimit të këtij lloji letrar.

Duke evidentuar këtë fakt Robert Elsie do të shkruajë se “Bashkërendimi i elementeve orientale dhe oksidentale nuk është kurrësi realist, por fakti është se ai përmban një dozë të mirë kritike sociale, sidomos për gjendjen e gruas në shoqërinë osmane”v.

Pas kësaj vepre, Pashko Vasa, pavarësisht statusit zyrtar si hierark oriental, nën ndikimin e letërsisë evropiane, sidomos asaj romantike e sentimentale italiane, gjë që e pasqyroi dhe në poezinë e tij, boton në gjuhën frënge në Paris më 1890, romanin feuilleton Bardha e Temalit (Bardha de Temal, scenes de la vie albanese). Ai konsiderohet si Romani me i vjetër me temë shqiptare krahas atij të Sami Frashëritvi. Historia zbavitëse midis Bardhës dhe Aradit pasurohet me përshkrimin e dokeve e zakoneve të botës shqiptare, për t’ia zbuluar këtë lexuesit evropian. Si të thuash është përpjekja e parë e thellë për të konfirmuar jo vetëm letrarisht, por dhe kulturalisht qenien e botës shqiptare brenda një rrethi kulturor evropian më të gjerë.

Romani është tipik sentimental-romantik, ndonëse jo në lartësinë e duhur, për shkak të përshkrimeve të shumta dhe shfaq më së miri tendencën identitare evropiane të botës së letrave shqiptare.

Për t’u shënuar në këtë fazë, e cila mund të konsiderohet më shumë si pararomaneske janë dhe romanet e Anton Santorit përkatësisht “Sofia Kominiane” i papërfunduar, shkruar në italisht e shqip e mbetur në dorëshkrim dhe “Ushtari Arbëresh” (Il soldato albanese) shkruar në italisht. Kulti i atdheut jepet tek ky i fundit në sfondin e një historie me karakter sentimental-melodramatik dhe përfshin në kombinim hapësinor dhe kohor Shqipërinë dhe mjedisin arbëresh.

Vlera e tyre më e madhe qëndron në faktin se i përkasin asaj pjesë të letërsisë shqiptare që pikëtakimin me botën evropiane e kishte më të plotë dhe më të spikatur. Kontakti ishte jo vetëm fizik, gjeografik, por dhe politik e kulturor njëherazi. Autorët arbëreshë ishin aktivistë aktivë të jetës politike të Italisë së kohës dhe formimi i tyre natyrshëm ndikoi dhe në krijimtari.

Në këtë pikëpamje këto romane, pavarësisht performancës artistike, shkojnë natyrshëm drejt përshfaqjes së identitetit evropian të prozës e letërsisë shqipe në tërësi. Identiteti kombëtar shqiptar gjen kështu shtratin e duhur brenda identitetit evropian. Megjithatë ende brenda

vetvetes ai nuk është aq evropian sa dhe duhet. Rrëfimi i tij është kronikal, dhe intriga pa shumë përthyerje artistike, sikurse procedimet janë akoma të nivelit fillestar.

Kjo fazë pararomaneske tenton të kapërcehet në vitet 20-30 të shekullit XX, me romanet e Foqion Postolit, të cilat mbeten një sprovë për të kapur kohën e humbur në raport me romanin evropian, i cili kishte njohur tashmë disa kulme dhe kishte vendosur hegjemoninë e tij letrare. “Për mbrojtjen e Atdheut” është një krijim tipik në frymën e romantizmit kombëtar të viteve të fundit të rilindjesvii.

Në qendër sërish është një histori dashurie sentimentale, plot ideale e virtyte patriotike. “Lulja e Kujtimit” shfaq të njëjtën cektësi subjektore, por artistikisht shënon një hap përparaviii. Si histori dashurie e atdhetarie, ai mbetet një roman romantik që transmeton vlera identitare të kursyera evropiane, por konfirmon ecurinë e romanit shqiptar drejt formësimit e vijimësisë së pandryshuar të rrethit kulturor evropian.

Në krahasim me romanet e Nikajt, Postoli përforcon përpjekjen e përvetësimit të modeleve të romaneve evropiane, ku ngjarjet nuk i nënshtrohen kronikës bajate, por shtjellohen brenda një rrëfimi të rregulluar artistikisht. Megjithëse të përcaktuar si romantikë sentimentalistë, brenda tyre ka disa elemente të realizmit që i bëjnë këto romane akoma më shumë të përafrueshëm me disa modele të hershme të romaneve evropiane.

Pjesa tjetër e vokacionit të brendshëm, e përjetimeve, koncepteve për jetën, dashurinë , botëkuptimeve jetësore, është një univers sa kombëtar po aq dhe evropian pa u larguar ende plotësisht nga gjurmë të orientalizmit.

Fuqia e realizmit që përpiqet të shkëputet nga notat romantike dhe sentimentaliste vjen në romanin shqiptar me Haki Stërmillin. Romani i tij më i rëndësishëm “Sikur të isha djalë”, 1936 shënon një stacion të rëndësishëm në historinë e romanit shqiptar. Nuk është thjesht ndërtimi ditar i tij vlera kryesore.

Ai është bindës në ide, i pasur nga ana leksikore e stil narrativ realistix. Protagonistët zbulohen përgjatë ngjarjeve e konfliktit rrjedha e të cilit ndryshon në mënyrë të papritur. Dobësitë stilistikore dhe notat sentimentale e frenojnë disi entuziazmin letrar për këtë vepër. Por në tërësinë e saj ajo përfaqëson një shpalosje më të plotë të vlerave evropiane të romanit shqiptar në shumë drejtime.

Para Stërmillit, ishte Konica ai që me “doktor Gjilpërën” 1924, kishte goditur fort në kambanat evropianizuese të Romanit shqiptar. Ndonëse diskutimet roman apo novelë për këtë vepër vazhdojnë, ajo mbetet një kontribut i paçmuar në aspektin e forcës realiste dhe originalitetin satirik, sikurse shumë lehtë mund të konsiderohet një vepër alegorike.

“Dr. Gjilpëra është një vepër fiksiionale, një vepër art, por duhet të theksohet se në të ka një funksion të veçantë efekti i reales”x-shkruan Sabri Hamiti.

Të gjitha këto cilësi e bëjnë atë një vepër me vokacion dhe identitet të thellë evropian që paraqet më së miri identitetin tonë kombëtar me përshkrimet e mbarështrimin e ngjarjeve.

Me Sterjo Spassen, i cili e ndan krijimtarinë e tij në dy periudha para dhe pas luftës romani hyn në rrugën e tij realiste. Tërheq vëmendje romani Pse si “roman i mohimit”, por njëkohësisht dhe i pohimit identitar. Cikli i romaneve historikë të Spasses është një formë shpëtimi nga deviacionet e realizmit socialist.

Dilema e orientimit të romanit shqiptar do të ringjallet me imponimin në letërsinë tonë të kanoneve të realizmit socialist. Tendenca lindore, jo me të njëjtin vektor si në kohës së lindjes së tij, u shfaq si pikëpyetje nëse ky roman, sikurse e gjithë letërsia do bënte pjesë në rrethin kulturor të Evropës Lindore, ku dominanca ruse ishte e plotë, apo në atë perëndimor.

Kjo dilemë më shumë se kulturore dhe identitare ishte pikë së pari politike. Ajo në fakt, si një përplasje konceptesh, metodash e letërsish, ndihmoi dukshëm lindjen e talenteve të mëdha letrare, të cilët i vunë vulën vokacionit evropian të romanit tonë, duke i hequr atij inferioritetin dhe duke i dhënë përmasën e munguar evropiane në njohje dhe në vlerë.

Romanet Kadaresë e Agollit, por dhe të Kongolit, Xhuvanit, të Petro Markos, Sabri Godos, Jakov Xoxes, Vath Koreshit, Kasem Trebeshinës, Martin Camajt, Nazmi Rrahmanit janë romane me pasuri të jashtëzakonshme estetike e tematike, me forma rrëfimore të larmishme, analiza të thella, me intrigë e ngjarje të mbarështuara bukur artistikisht, brenda një hapësire dhe kohe në të cilat lëvizin protagonistë të skalitur me forcën e imagjinatës dhe realizmit. Përtej kufijve atij nuk i munguan modelet moderniste dhe tendencat e rrymave të ndryshme të letërsisë evropiane sidomos me Pashkun apo Qosen, Mustafain.

Kontribut të veçantë dhanë autorë disidentë si Bilal Xhaferri me romanin e tij shumëdimensional “Krastakraus”.

“Kështu proza moderne shqiptare vazhdon ta perfeksionojë gjuhën si mjet letrar dhe të gjitha mundësitë shprehëse të saj nëpërmjet llojeve më bashkëkohore të rrëfimit artistik”^{xi}

Romani shqiptar që nisi udhën e tij me romanin historik ose pseudo-historik, ku mbizotëroi intriga në dëm të mesazhit dhe cilësisë u evropianizua në thelbin e tij gjatë një rrugëtimi jo të lehtë. Nga kronika historike ai kaloi në filozofinë e historisë me Kadarenë dhe autorë të tjerë ku dominonte simbolizmi, i cili tejkalonte personazhin real historik. Këto u pasuan pas viteve 90 me romane nga autorë më të rinj, të cilët krahas mesazhit, ndërtojnë personazhe të komplikuar që e mishërojnë brenda formave të interpretimit të historisë, karaktere historike interesante.

Liria e post 90-të dha efektet e saj dhe në shpërthimin e zhvillimit të llojeve të ndryshme të romanit, si një tendencë e natyrshme identitare evropiane. Tërheqin vëmendje romanet që kanë në qendër tmerret e diktaturës, por dhe kaosin social e mental në pragdemokracinë e sapolindur shqiptare, të Kongolit, Agron Tufës, Virion Gacit, Roland Gjozës në formën e romaneve socio-filozofikë, ose të romaneve horror me nota të forta natyraliste. Temat e ekzistencës e absurdit, e

individit në konflikt me shoqërinë, e përballjes më emigrimin, sfidat e vdekjes e të dashurisë, si tema panevropiane, do jenë pjesë e një serie romanesh të autorëve të rinj.

Ndërkohë, shkrimtarë e tjerë të ikur nga Shqipëria, por të suksesshëm në Shqipëri me veprat e tyre, krijojnë një botë romaneske që shkrin çdo kufi midis identitetit evropian dhe atij kombëtar, duke kontribuar në përvijimin më të plotë të këtij të fundit si pjesë pasuruese e identitetit evropian.

Romani shqiptar u shfaq në horizontin e letërsisë shqipe, si një roman me vokacion të fortë evropian dhe vazhdon të jetë i tillë brenda identiteti të spikatur kombëtar.

Në ndryshim nga poezia që përjetoi përpëlitjet e saj në momente të caktuara, romani nuk humbi asnjë moment koloritin e tij si pjesë dëshmuuese se letërsia shqiptare është pjesë integrale e rrethit kulturor identitar evropian.